



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 1174 / prot.

Tiranë më 18. 7. 2018

Lënda: Mendim mbi projekt marrëveshjen “Për bashkëpunim në fushën e sigurisë së kufirit”

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.5875 Prot., datë 12.07.2018, projekt marrëveshja “Për bashkëpunim në fushën e sigurisë së kufirit”, vlerësohet e hartuar konform ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Me qëllim përshtatjen me terminologjinë e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë që përkufizimi i termave, “*Të dhëna personale*” si dhe “*Përpunim i të dhënave personale*”, të parashikuara në nenin 2 të projekt marrëveshjes, të jetë i plotë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, në kuadër të transpozimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR-së) dhe Direktivës së Policisë 2016/680 në legjislacionet respektive të dy vendeve, si dhe ndryshimeve të mundshme që mund të ndodhin e që nuk janë të parashikuara në Marrëveshjen “*Mbi bashkëpunimin Policor*”, sugjerojmë që në fund të nenit 14 të projekt marrëveshjes, të shtohet togfjalëshi “*...dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

